


REKOMANDIME

PËR PËRMIRËSIMIN E TRANSFEREVE FINANCIARE NGA QEVERIA PËR PROJEKTET INFRASTRUKTURE TË KOMUNAVE

Në prag të zgjedhjeve lokale të fundit, komunat morën një "injektim" të konsiderueshëm financiar nga Qeveria për projekte infrastrukturore të financuara nga e ashtuquajtura kredi hungareze. Vetëm në atë vit, komunave u janë aprovuar projekte në vlerë prej 112 milionë euro, me projektimin nga Qeveria se përkrahja e përgjithshme do të arrijë vlerën prej 250 milion euro në periudhë prej tre vitesh. Këto mjete kanë çuar deri në një rritje mesatare prej 92 % të shumave për shpenzimet kapitale të komunave në vitin e zgjedhjeve, në raport me realizimin e vitit të mëparshëm.

Edhe pse në infrastrukturën lokale nevojiten investime, megjithatë momenti dhe modeli i realizimit të tyre hapin çështje serioze për aprovim dhe financim të drejtë dhe përgjegjshëm të këtyre projekteve të komunave.

Hulumtimin "Injektiv" me vlerë prej 112 milionë euro nga qeveria për komunat në vitin e zgjedhjeve lokale mund ta gjeni në gjuhën maqedonase, gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze



Hulumtimi dhe analiza mbi ndarjen e projekteve infrastrukturore nëpër komunitat nga programi qeveritar për decentralizim: **“Injektim” me vlerë prej 112 milionë euro nga Qeveria për komunitat në vitin e zgjedhjeve lokale** kanë sinjalizuar në disa sfida kryesore:

- Miratimi i fondeve të konsiderueshme nga pushteti qendror në pushtetin lokal në periudhën para mbajtjes së zgjedhjeve lokale;
- Shpërndarje jo e barabartë e fondeve për kokë banori dhe sipas madhësisë së komunës, si dhe përjashtimi i disa vetëqeverisjeve lokale;
- Shkalla e ulët e realizimit financiar dhe transferimi i fondeve për vitin e ardhshëm;
- Klasifikimi i projekteve si “zhvillimore” mbi bazën e financimit të tyre shumëvjeçar, megjithëse pjesë e madhe e tyre janë në lidhje me infrastrukturën aktuale lokale;
- Mospërfillja e sugjerimeve nga Këshilli Fiskal për rreziqet që këto projekte i përfshijnë, përkatësisht për mundësinë që ato të interpretohen si masë populiste para zgjedhjeve dhe që pjesë e madhe e këtyre fondeve të mos përdoren tërësisht ose të mos përdoren në mënyrë efikase;
- Shkurtim i konsiderueshëm i fondeve menjëherë pas zgjedhjeve, nga shuma fillimisht e planifikuar dhe e paralajmëruar prej 250 milionë euro në 149 milionë euro;
- Përfaqësim minimal i projekteve që drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve për jetë dhe punë për gratë, të rinjtë dhe grupet e marginalizuara (më pak se 1 % e numrit të përgjithshëm të projekteve);
- Indicie për rreziqe në prokurimet publike dhe dominim të një apo disa kompanive që i kanë fituar kontratat për prokurime publike për ndërtimin e projekteve.

Këto gjetje nga hulumtimi i zhvilluar gjithsesi që nuk e vënë në pikëpyetje nevojën për investim në komunitat dhe për investim në zhvillimin lokal në vend. Por, mangësitë e detektuara në alokimin e fundit të fondeve të këtyre komunat, si dhe përvojat e mëparshme, e theksojnë nevojën për një implementim më të parashikueshëm, më të drejtë dhe më të qartë të këtyre projekteve, me planifikim buxhetor më stabil.

Në këtë mënyrë do të mundësohet përdorim më racional dhe më efektiv i parave publike, por do të krijohet edhe besim më i madh në institucionet dhe në mbrojtjen e tyre nga perceptimi potencial për keqpërdorimin e fondeve publike për qëllime politike.

Së këtejmi, në këtë dokument të shkurt propozohen masa konkrete për përmirësimin e shpërndarjes së mjeteve për ndërtimin e infrastrukturës komunale nëpërmjet vendosjes së kritereve më thelbësore për shpërndarje të fondeve, shpërndarje të fondeve më me plan si dhe fuqizim të mbikëqyrjes.



REKOMANDIME

Duke i pasur parasysh gjetjet nga hulumtimi dhe shqetësimin që u shkaktua nga momenti dhe modeli i shpërndarjes së këtyre fondeve, imponohen një sërë rekomandimesh për masat që duhet të zbatohen për t'u mundësuar financimi i drejtë dhe i qëndrueshëm i projekteve infrastrukturore, në interes të të gjithë qytetarëve.

01

Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës lokale duhet të bazohet në politikë të parashikueshme, pavarësisht cikleve zgjedhore. Kjo duhet të përfshijë planifikim strategjik, shumëvjeçar dhe shpenzim sipas një kornize afatmesme buxhetore.

02

Projektet shumëvjeçare duhet të kenë të siguar financim stabil dhe detyrues. Me këtë do të zvogëlohen rreziqet nga zvarritja e realizimit të projekteve dhe mospërfundimit të tyre, ndërsa do të përforcohet edhe kredibiliteti financiar i komunave.

03

Të garantohet qasje e barabartë dhe shpërndarje e drejtë e fondeve për të gjitha komunat dhe banorët. Kjo do të nënkuptojë të merren parasysh edhe indikatorët për baraspeshën rajonale, zhvillimore dhe sociale, me çka do të kontribuohet për rritjen e barazisë ndërmjet banorëve.

04

Elementi "zhvillimor" i projekteve varet nga ndikimi i tyre, efektet shumëdimensionale, qëndrueshmëria dhe ndikimi socio-ekonomik. Në këtë mënyrë do të stimulohen projekte në drejtim të zhvillimit, pavarësisht periudhës kohore të financimit të tyre.

05

Transparenca në procedurat e shpërndarjes dhe në zbatimin e projekteve duhet të jetë më e madhe dhe më e detajuar. Kjo donë të thotë publikim të notave nga evaluimi i projekteve, arsyet për pranimin dhe refuzimin e aplikimeve, duke përfshirë edhe informim më të shpeshtë për shumën e aprovuar, të dakorduara dhe të paguara për çdo komunë, si dhe për progresin në realizimin e projekteve, për zbatimin e prokurimeve publike për projektet dhe publikim të raporteve nga revizionet eventuale të projekteve.

06

Të revidohen rregullat për mbrojtjen e resurseve publike prej keqpërdorimeve të mundshme parazgjedhore. Në këtë drejtim duhet të merren parasysh përvojat e deritanishme të mbrojtjes formale, por jo edhe thelbësore të resurseve publike dhe mbi këtë bazë të përpilohen rregulla të reja dhe më restriktive për shpenzim, për promovimin e projekteve publike dhe për një informim më të detajuar për shpenzimet buxhetore në periudhat parazgjedhore.

Duke e pasur parasysh që investimet në infrastrukturën lokale janë me rëndësi thelbësore për zhvillimin lokal, ato duhet të planifikohen dhe zbatohen me kohë dhe në mënyrë strategjike, t'i reduktojnë dallimet brenda dhe ndërmjet komunave dhe përfundimisht – ta rrisin besimin e publikut.

Së këtejmi, këto rekomandime duhet të ripërpunohen në hapa konkretë detyra të detajuara, periudhë kohore për zbatimin e tyre, institucionet kompetente dhe indikatorët për sukses. Gjithsesi, përgjegjësinë kryesore për zbatimin e këtyre rekomandimeve e ka Qeveria, komunat, Kuvendi, Ministria e Financave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Enti Shtetëror për Revizion.